



# FERRA & CO sh.p.k

Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar

Data e themelimit: 18 Tetor 1995

Numri unik i indentifikimit(NIPT): J61805508W

## PASQYRAT FINANCIARE 2022

(Mbyllur më 31 Dhjetor 2022)

Pasqyra financiare: Individuale (jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022

Data e mbylljes: 18 Mars 2023

Monedha: Lekë

Shkalla e rrumbullakimit: Lekë

Durrës, Mars 2023

## TABELA E PËRMBAJTJES

|   |      |
|---|------|
| A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR.....         | 0    |
| B. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI)..... | 3-4  |
| AKTIVI .....                                    | 3    |
| DETYRIME DHE KAPITALI.....                      | 4    |
| C. PASQYRA E PERFORMANCES .....                 | 5-6  |
| PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE .....    | 5    |
| PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE .....  | 6    |
| D. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE.....   | 7    |
| E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO..... | 8    |
| F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE .....        | 9-20 |

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI)  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

| Nr                           | Përshkrimi i Elementëve                             | Shënime | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|------------------------------|---|---------|------------------------------|-------------------------------|
| <b>AKTIVI</b>                |   |         |                              |                               |
| <b>I AKTIVE AFATSHKURTRA</b> |   |         |                              |                               |
| 1                            | <b>Mjete Monetare</b>                               | 5       | 37.216.148                   | 47.694.860                    |
|                              | <b>Investime Financiare</b>                         |         | -                            | -                             |
|                              | <b>Të Drejta të Arketueshme</b>                     | 6       |                              |                               |
|                              | Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit (Kliente)             |         | 338.890.859                  | 290.702.792                   |
|                              | Njesite Ekonomike Brenda Grupit                     |         | -                            | -                             |
|                              | Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike            |         | -                            | -                             |
|                              | Të tjera (Debitore të tjere)                        |         | 1.160.267.162                | 673.308.659                   |
|                              | Kapital i Nenshkruar i Papaguar                     |         |                              |                               |
|                              | <b>Totali i te Drejtave te Arketueshme</b>          |         | <b>1.499.158.021</b>         | <b>964.011.451</b>            |
| 2                            | <b>Inventari</b>                                    | 7       |                              |                               |
|                              | Lende e Pare dhe Materiale të Konsumueshme          |         | 232.568.854                  | 65.215.969                    |
|                              | Prodhime ne Proces dhe Gjysemprodukte               |         | -                            | -                             |
|                              | Produkte te Gatshme                                 |         | -                            | -                             |
|                              | Mallra  |         | 173.055.271                  | 247.275.085                   |
|                              | Aktive Biologjike                                   |         | -                            | -                             |
|                              | AAM te Mbajtura per Shitje                          |         | -                            | -                             |
|                              | Parapagime per Inventar                             |         | -                            | -                             |
|                              | <b>Totali i Inventarit</b>                          |         | <b>405.624.125</b>           | <b>312.491.054</b>            |
| 3                            | <b>Shpenzime te Shtyra</b>                          | 8       | -                            | -                             |
| 4                            | <b>Te Arketueshme nga te Ardhurat e Konstatuara</b> |         | -                            | -                             |
|                              | <b>TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA</b>               |         | <b>1.941.998.294</b>         | <b>1.324.197.365</b>          |
| <b>II AKTIVE AFATGJATA</b>   |   |         |                              |                               |
| 1                            | <b>Aktive Financiare:</b>                           |         |                              |                               |
|                              | Tituj Pronesie në Njs. Ekon. Brenda Grupit          |         | -                            | -                             |
|                              | Tituj Huadhenieje ne Njes. Ekon. Brenda Grupit      |         | -                            | -                             |
|                              | Tituj Pronesie ne Njs.Ekon. Pjesëmarrje             |         | -                            | -                             |
|                              | Tituj Huadhenieje në Njes. Ekon. Pjesëmarrjeje      |         | -                            | -                             |
|                              | Tituj te tjere (Aktive Afatgjata)                   |         | -                            | -                             |
|                              | Tituj te tjere te Huadhenies                        |         | -                            | -                             |
|                              | <b>Totali i Aktiveve Financiare</b>                 |         | -                            | -                             |
| 2                            | <b>Aktive Materiale:</b>                            | 9       |                              |                               |
|                              | Toka dhe Ndertesa                                   |         | 2.269.460.122                | 2.299.206.258                 |
|                              | Impiante dhe Makineri                               |         | 163.300.289                  | 161.593.640                   |
|                              | Instalime dhe Pajisje                               |         | 50.320.622                   | 55.755.625                    |
|                              | Parapagime per Aktive Materiale dhe ne Proces       |         | -                            | -                             |
|                              | <b>Totali i Aktiveve Materiale</b>                  |         | <b>2.483.081.033</b>         | <b>2.516.555.523</b>          |
| 3                            | <b>Aktive Biologjike</b>                            |         | -                            | -                             |
| 4                            | <b>Aktive Jo-Materiale</b>                          |         |                              |                               |
|                              | Koncesione, Patenta, Licenca, Marka Tregtare        |         | -                            | -                             |
|                              | Emri i Mire   |         | -                            | -                             |
|                              | Parapagime per Aktive Afatgjata Jo Materiale        |         | -                            | -                             |
|                              | <b>Totali i Aktiveve Jo-Materiale</b>               |         | -                            | -                             |
| 5                            | <b>Aktive Tatimore te Shtyra</b>                    |         | -                            | -                             |
|                              | <b>TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA</b>                  |         | <b>2.483.081.033</b>         | <b>2.516.555.523</b>          |
|                              | <b>TOTALI I AKTIVEVE</b>                            |         | <b>4.425.079.327</b>         | <b>3.840.752.888</b>          |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI)-VAZHDIM  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

| Nr  | Përshkrimi i Elementëve                                  | Shënime | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|---|--|---------|------------------------------|-------------------------------|
| <b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>                 |  |         |                              |                               |
| <b>I</b>                                      | <b>DETYRIME AFATSHKURTRA</b>                             | 10      |                              |                               |
|   | Titujt e Huamarrjes                                      |         | -                            | -                             |
|   | Detyrime ndaj Institucioneve te Kredise                  |         | 797.347.650                  | 637.579.279                   |
|   | Arketime ne Avance per Porosi                            |         | 2.417.500                    | 1.500.000                     |
|   | Te Pagueshme per Aktivitetin e Shfrytezimit (Furnitore)  |         | 394.628.854                  | 31.930.054                    |
|   | Deftesa te Pagueshme                                     |         | -                            | -                             |
|   | Te Pagueshme ndaj Njes. Ekon. Grup                       |         | -                            | -                             |
|   | Te Pagueshme ndaj Njes.Ekon. Pjesemarrje                 |         | -                            | -                             |
|   | Te Pagueshme ndaj Punonjesve dhe Sigurime Shoq./Shendet. |         | -                            | -                             |
|   | Te Pagueshme per Detyrime Tatimore                       |         | 7.987.463                    | 13.953.623                    |
|   | Te tjera te Pagueshme                                    |         | 473.087                      | 9.201.056                     |
| 1   | <b>Totali i Detyrimeve Afatshkurtra</b>                  |         | <b>1.202.854.554</b>         | <b>694.164.012</b>            |
| 2   | Te Pagueshme per Shpenzime te Konstatuara                |         | -                            | -                             |
| 3   | Te Ardhura te Shtyra dhe Grantet                         |         | -                            | -                             |
| 4   | Provizionet  |         | -                            | -                             |
| <b>TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA</b>       |  |         | <b>1.202.854.554</b>         | <b>694.164.012</b>            |
| <b>II</b>                                     | <b>DETYRIMET AFATGJATA</b>                               | 11      |                              |                               |
|   | Titujt e Huamarrjes                                      |         | -                            | -                             |
|   | Detyrime ndaj Institucioneve të Kredise                  |         | 295.749.249                  | 415.197.386                   |
|   | Arketime në Avance per Porosi                            |         | -                            | -                             |
|   | Te Pagueshme per Aktivitet Shfrytezues (Furnitore)       |         | -                            | -                             |
|   | Deftesa te Pagueshme                                     |         | -                            | -                             |
|   | Te Pagueshme Ndaj Njes. Ekon. Grup                       |         | -                            | -                             |
|   | Te Pagueshme Ndaj Njes. Ekon. Pjesemarrje                |         | -                            | -                             |
|   | Te tjera te Pagueshme                                    |         | -                            | -                             |
| 1   | <b>Totali i Detyrimeve Afatgjata</b>                     |         | <b>295.749.249</b>           | <b>415.197.386</b>            |
| 2   | Te Pagueshme per Shpenzime te Konstatuara                |         | -                            | -                             |
| 3   | Të Ardhura te Shtyra                                     |         | -                            | -                             |
| 4   | Provizione   |         | -                            | -                             |
| 5   | Detyrime Tatimore te Shtyra                              |         | -                            | -                             |
| <b>TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA(II)</b>      |  |         | <b>295.749.249</b>           | <b>415.197.386</b>            |
| <b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>                    |  |         | <b>1.498.603.803</b>         | <b>1.109.361.398</b>          |
| <b>III</b>                                    | <b>KAPITALI DHE REZERVAT</b>                             | 12      |                              |                               |
| 1   | <b>Kapitali i Nenshkruar</b>                             |         | 1.800.000.000                | 1.800.000.000                 |
| 2   | <b>Primi i Lidhur me Kapitalin (-)</b>                   |         | -                            | -                             |
| 3   | <b>Rezerva Rivleresimi</b>                               |         | -                            | -                             |
| 4   | <b>Rezerva te tjera:</b>                                 |         |                              |                               |
|   | Rezerva Ligjore  |         | 178.856.916                  | 178.856.916                   |
|   | Rezerva Statutore  |         | -                            | -                             |
|   | Rezerva te tjera   |         | -                            | -                             |
| 5   | <b>Fitimi i Pashperndare</b>                             |         | 752.534.574                  | 612.406.962                   |
| 6   | <b>Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar</b>                 |         | 195.084.034                  | 140.127.612                   |
|   | <b>TOTALI I KAPITALIT DHE REZERVAVE</b>                  |         | <b>2.926.475.524</b>         | <b>2.731.391.490</b>          |
| <b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT NETO</b> |  |         | <b>4.425.079.327</b>         | <b>3.840.752.888</b>          |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E PERFORMANCËS  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

A.PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE  
(SHPENZIMET E SHFRYTËZIMIT TË KLASIFIKUARA SIPAS NATYRËS)

| Nr | Përshkrimi i Elementëve                                     | Shënime   | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|----|---|-----------|------------------------------|-------------------------------|
| 1  | Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit                    | 13        | 4.773.634.960                | 3.415.006.871                 |
| 2  | Ndryshimi ne inventarin e PG&PP                             |           | -                            | -                             |
| 3  | Puna e kryer nga njësia dhe e kapitalizuar                  | 13        | -                            | -                             |
| 4  | Të ardhura të tjera të shfrytëzimit                         | 13        | 16.712.605                   | 7.532.465                     |
| 5  | <b>Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme:</b>          | 14        |                              |                               |
|    | Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme                  |           | (4.180.736.200)              | (2.935.471.496)               |
|    | Shpenzime te tjera  |           | (36.596.033)                 | (28.186.096)                  |
| 6  | <b>Shpenzime personeli</b>                                  | 15        |                              |                               |
|    | Paga dhe shperblime   |           | (86.117.294)                 | (81.238.121)                  |
|    | Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore           |           | (14.378.368)                 | (13.533.174)                  |
| 7  | <b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>           |           | -                            | -                             |
| 8  | <b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>                     | 9         | (79.910.436)                 | (72.445.377)                  |
| 9  | <b>Shpenzime te tjera shfrytezimi</b>                       | 16        | (105.645.908)                | (87.720.186)                  |
|    | <b>TOTALI I SHPENZIMEVE(6-9)</b>                            |           | <b>(4.503.384.239)</b>       | <b>(3.218.594.450)</b>        |
|    | <b>FITIMI/(HUMBJA) OPERACIONALE(1-9)</b>                    |           | <b>286.963.326</b>           | <b>203.944.886</b>            |
| 10 | <b>Të ardhura të tjera</b>                                  |           |                              |                               |
|    | Te Ardhura nga pjesemarrja ne njesi të tjera                |           | -                            | -                             |
|    | Te ardhura nga investimet dhe huate                         |           | -                            | -                             |
|    | Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme |           | -                            | -                             |
|    | <b>TOTALI I TE ARDHURAVE TE TJERA</b>                       |           | <b>-</b>                     | <b>-</b>                      |
| 11 | <b>Zhvleresimi i aktiveve dhe invest. financiare (AASH)</b> |           | -                            | -                             |
| 12 | <b>Shpenzime financiare</b>                                 | 17        | -                            | -                             |
|    | Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme                |           | (33.056.062)                 | (31.606.990)                  |
|    | Shpenzimet e tjera financiare                               |           | (23.869.155)                 | (6.484.678)                   |
|    | <b>TOTALI TE ARDHURAVE(SHPEN) FINANCIARE</b>                |           | <b>(56.925.217)</b>          | <b>(38.091.668)</b>           |
| 13 | <b>Pjesa e fitimit/(Humbjes) nga pjesemarrja</b>            |           | -                            | -                             |
|    | <b>FITIMI/(HUMBJA) PARA TATIMIT</b>                         | <b>0</b>  | <b>230.038.109</b>           | <b>165.853.218</b>            |
|    | <b>SHPENZIME(TE ARDHURA) PER TATIMIN MBI FITIMIN</b>        | <b>18</b> | <b>(34.954.075)</b>          | <b>(25.725.606)</b>           |
|    | Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin                      |           | (34.954.075)                 | (25.725.606)                  |
|    | Shpenzime/(të ardhura) i tatim fitimit të shtyre            |           | -                            | -                             |
|    | Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve                      |           | -                            | -                             |
|    | <b>FITIMI/(HUMBJA) E VITIT FINANCIAR</b>                    |           | <b>195.084.034</b>           | <b>140.127.612</b>            |
|    | <b>Fitimi/(Humbja) per:</b>                                 |           |                              |                               |
|    | Pronaret e njesise ekonomike meme                           |           | -                            | -                             |
|    | Interesat jo-kontrolluese                                   |           | -                            | -                             |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E PERFORMANCËS-VAZHDIM  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

B.PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

| Nr  | Përshkrimi i Elementëve   | Shënime | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|-----|---|---------|------------------------------|-------------------------------|
| I   | <b>FITIMI/(HUMBJA) E VITIT FINANCIAR</b>                              |         | 195.084.034                  | 140.127.612                   |
| II  | Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:                      |         |                              |                               |
|     | Diferencat nga përkth. i monedhes ne veprimt. te huaja                |         | -                            | -                             |
|     | Diferencat nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale             |         | -                            | -                             |
|     | Diferencat nga rivleresimi i aktiveve fin. te mbaj.shitje             |         | -                            | -                             |
|     | Pjesa e te ardhurave gjithepersh. nga pjesemarrjet                    |         | -                            | -                             |
|     | Te tjera te ardhura gjithepershirese per vitin                        |         | -                            | -                             |
|     | <b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin(II)</b> |         | <b>-</b>                     | <b>-</b>                      |
| III | <b>TOTALI TE ARDHURAVE(HUMBJEVE)GJITHEPERFSHIRESE(I+II)</b>           |         | <b>195.084.034</b>           | <b>140.127.612</b>            |
|     | <b>TOTALI TE ARDHURAVE(HUMBJEVE)GJITHEPERFSHIRESE PER:</b>            |         | -                            | -                             |
|     | Pronarët e njësisë ekonomike mëmë                                     |         | -                            | -                             |
|     | Interesat jo-kontrolluese   |         |                              |                               |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (METODA INDIREKTE)  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

| Nr         | Përshkrimi i Elementëve  | Shënime | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|------------|--|---------|------------------------------|-------------------------------|
| <b>I</b>   | <b>FLUKSI I MJETEVE MONETARE NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT</b> |         |                              |                               |
|            | <b>FITIMI /(HUMBJA) E VITIT FINANCIAR</b>                      |         | <b>195.084.034</b>           | <b>140.127.612</b>            |
|            | Rregullimet për shpenzimet jomonetare:                         |         |                              |                               |
|            | Shpenzime financiare jo-monetare                               |         | -                            | -                             |
|            | Shpenzime për tatimin mbi fitimin jo-monetar                   |         | -                            | 18.370.421                    |
|            | Shpenzime konsumi dhe amortizimi                               |         | 79.910.436                   | 72.445.377                    |
|            | Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale                     |         | -                            | -                             |
|            | Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata materiale               |         | (1.137.000)                  | -                             |
|            | <b>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit:</b>     |         |                              |                               |
|            | Rritje/renie në të drejtat e arketueshme dhe të tjera          |         | (535.146.570)                | (50.560.536)                  |
|            | Rritje/renie në inventar                                       |         | (93.133.071)                 | 37.284.347                    |
|            | Rritje/renie në detyrimet e pagueshme                          |         | 508.690.542                  | (42.379.778)                  |
|            | Rritje/renie në detyrimet ndaj punonjësve                      |         | -                            | (1.928.124)                   |
|            | <b>MJETE MONETARE NETO NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT</b>       |         | <b>154.268.371</b>           | <b>173.359.319</b>            |
| <b>II</b>  | <b>FLUKSI I MJETEVE MONETARE NGA AKTIVITETI I INVESTIMIT</b>   |         |                              |                               |
|            | Para neto të përdorura për blerjen e filialeve                 |         | -                            | -                             |
|            | Para neto të arketuara nga shitja e filialeve                  |         | -                            | -                             |
|            | Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale              |         | (57.264.946)                 | (145.847.160)                 |
|            | Arkitime nga shitja e aktiveve sftatgjata materiale            |         | 11.966.000                   | -                             |
|            | Pagesa për blerjen e investimeve të tjera                      |         | -                            | -                             |
|            | Arkitime nga shitja e investimeve të tjera                     |         | -                            | -                             |
|            | Dividende të arketuar  |         | -                            | -                             |
|            | <b>MJETE MONETARE NETO NGA AKTIVITETI I INVESTIMIT</b>         |         | <b>(45.298.946)</b>          | <b>(145.847.160)</b>          |
| <b>III</b> | <b>FLUKSI I MJETEVE MONETARE NGA AKTIVITETI I FINANCIMIT</b>   |         |                              |                               |
|            | Arkitime nga emetimi i kapitalit aksionar                      |         | -                            | -                             |
|            | Arkitime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral     |         | -                            | -                             |
|            | Hua të arketuara   |         | (119.448.137)                | (15.729.235)                  |
|            | Pagesa e kostove transaksionale (hua dhe kredi)                |         | -                            | -                             |
|            | Riblerje e aksioneve të veta                                   |         | -                            | -                             |
|            | Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral                   |         | -                            | -                             |
|            | Pagesa e huave   |         | -                            | -                             |
|            | Pagese e detyrimeve prej qirase financiare                     |         | -                            | -                             |
|            | Interes i paguar   |         | -                            | -                             |
|            | Dividende të paguar  |         | -                            | -                             |
|            | <b>MJETE MONETARE NETO NGA AKTIVITETI I FINANCIMIT</b>         |         | <b>(119.448.137)</b>         | <b>(15.729.235)</b>           |
| <b>IV</b>  | <b>RRITJE/RENIE NETO NE MJETE MONETARE DHE EK</b>              |         | <b>(10.478.712)</b>          | <b>11.782.924</b>             |
|            | MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET NE FILLIM TE PERIUDHES        |         | <b>47.694.860</b>            | <b>35.911.936</b>             |
|            | EFEKTI I LUHATJEVE TE KURSIT TE KEMBIMIT                       |         | -                            | -                             |
|            | MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET NE FUND TE PERIUDHES          |         | <b>37.216.148</b>            | <b>47.694.860</b>             |


Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

| Nr | Përshkrimi i Elementëve  | KAPITALI I NENSHKRUAR | PRIMI I LIDHUR ME KAPITALIN | REZERVA RIVLERESIMI | REZERVA LIGJORE, STATUTORE DHE TE TJERA | FITIMI I PASHPERNDARE | FITIMI/(HUMBJA) E VITIT | TOTALI        |
|----|--|-----------------------|-----------------------------|---------------------|---|-----------------------|-------------------------|---------------|
| A  | <b>Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2020</b>                                      | 1.800.000.000         | -                           | -                   | 178.856.916                             | 538.559.964           | 73.846.998              | 2.591.263.878 |
|    | kontabel   | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | -                       | -             |
|    | <b>Pozicioni Financiar i Rideklaruar më 1 Janar 2021</b>                           | 1.800.000.000         | -                           | -                   | 178.856.916                             | 538.559.964           | 73.846.998              | 2.591.263.878 |
|    | <b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse per vitin:</b>                              |                       |                             |                     |   |                       |                         |               |
| 1  | Fitimi / Humbja e Vitit  | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | 140.127.612             | 140.127.612   |
|    | Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse  | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | -                       | -             |
|    | <b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitin:</b>                          | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | 140.127.612             | 140.127.612   |
|    | <b>Transaksionet me pronaret e njësise ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b> |                       |                             |                     |   |                       |                         |               |
| 2  | Emetimi i kapitalit te nenshkruar (+ndryshimet brenda zerave)                      | -                     | -                           | -                   | -                                       | 73.846.998            | (73.846.998)            | -             |
|    | Dividende te paguar  | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | -                       | -             |
|    | <b>Totali i transaksioneve me pronaret e njësise ekonomike</b>                     | -                     | -                           | -                   | -                                       | 73.846.998            | (73.846.998)            | -             |
| B  | <b>Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2021</b>                                      | 1.800.000.000         | -                           | -                   | 178.856.916                             | 612.406.962           | 140.127.612             | 2.731.391.490 |
|    | kontabel   | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | -                       | -             |
|    | <b>Pozicioni Financiar i Rideklaruar më 1 Janar 2022</b>                           | 1.800.000.000         | -                           | -                   | 178.856.916                             | 612.406.962           | 140.127.612             | 2.731.391.490 |
|    | <b>Te ardhura totale gjithëpërfshirëse per vitin:</b>                              |                       |                             |                     |   |                       |                         |               |
| 1  | Fitimi / Humbja e Vitit  | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | 195.084.034             | 195.084.034   |
|    | Të Ardhura të tjera gjithëpërfshirëse  | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | -                       | -             |
|    | <b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitin:</b>                          | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | 195.084.034             | 195.084.034   |
|    | <b>Transaksionet me pronaret e njësise ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b> |                       |                             |                     |   |                       |                         |               |
| 2  | Emetimi i kapitalit te nenshkruar (+ ndryshimet brenda zerave)                     | -                     | -                           | -                   | -                                       | 140.127.612           | (140.127.612)           | -             |
|    | Dividende te paguar  | -                     | -                           | -                   | -                                       | -                     | -                       | -             |
|    | <b>Totali i transaksioneve me pronaret e njësise ekonomike</b>                     | -                     | -                           | -                   | -                                       | 140.127.612           | (140.127.612)           | -             |
| C  | <b>Pozicioni Financiar më 31 Dhjetor 2022</b>                                      | 1.800.000.000         | -                           | -                   | 178.856.916                             | 752.534.574           | 195.084.034             | 2.926.475.524 |

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "FERRA & CO" sh.p.k dhe jane firmosur nga Administratori -Isuf Ferra Financieri-Shpresa Harka



SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

### 1. Informacione te pergjitheshme

Shoqëria tregtare "FERRA & CO" sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar më 18 Tetor 1995 dhe vepron në përputhje me ligjin "Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri. Në regjistrin tregtar(QKR) shoqëria është e identifikuar me NIPT-in J J61805508W dhe ka selinë kryesore e saj në Shkozë, Durrës. Kapitali regjistruar aktualisht është 1.800.000.000 leke dhe zotërohet nga ortakut i vetëm z. Isuf Ferra.

Veprimtaria kryesore tregtare për ushtrimin 2022 kanë qënë tregtia me shumice dhe pakice e mallrave ushqimore, të cilën e ushtron në gjithë territorin e Shqipërisë.

Nuk ka segmente shfrytëzimi të identifikuar qartë, për të cilat të ketë informacion financiar të veçantë dhe që ndiqen e shqyrtohen rregullisht nga drejtimi për të vlerësuar performancën e tyre.

### 2. Deklaratë e pajtueshmërisë me SNRF-të

Pasqyrat financiare(individuele) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

### Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara

#### 3. Bazat e matjes të përdorura

Pasqyrat financiare, përveç informacionit të flukseve të mjeteve monetare, janë përgatitur duke përdorur *bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara të kontabilitetit*. Mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, elementët njihen si aktive, detyrime, kapital, të ardhura apo shpenzime kur ato plotësojnë përkufizimet dhe kriteret e njohjes për këto zëra.

Për matjen e vlerave monetare të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, në pasqyrat e saj financiare, shoqëria ka zgjedhur si bazë matjeje kosto historike dhe në raste të veçanta baza të tjera matjeje të lejuara nga standardet.

Paraqitja e tyre është bërë në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

#### 4. Politikat e tjera kontabël të përdorura që janë të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.

##### 4.1 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

##### 4.2 Aktivitet dhe detyrimet financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në percaktimet e SNK-1, "Paraqitja e Pasqyrave Financiare".

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e që plotësojnë kushtet e percaktuara në pikën 11.9 seksioni 11 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shumat për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shumat e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

#### 4.3 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SNK-2 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Çmuarjet, bazohen në evidencën më të besueshme që ekziston, në kohën kur bëhen këto vlerësime dhe marrin në konsideratë luhatjet e çmimit apo të koston që lidhet drejtpërdrejtë me ngjarjet që ndodhin pas datës raportimit. Shumat e çdo zhvlerësimi të inventarëve njihet si shpenzim në periudhën kur ndodh zhvlerësimi ose humbja.

#### 4.4 Aktivët afatgjatë financiarë

Investimet në njësitë ekonomike të kontrolluara dhe në pjesëmarrje, në pasqyrat financiare individuale, që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje, paraqiten në përputhje me paragrafet 37-42 të SNK 27 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale". Ato njihen fillimisht në kontabilitet me koston e blerjes dhe në pasqyrat financiare pas blerjes, me koston minus zhvlerësimin.

#### 4.5 Aktivët afatgjatë materiale

Aktivët afatgjatë materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiviteti kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të hyrë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet

me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfutimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e kostos dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor

Vlera kontabël (neto) e AAM-ve rishikohet në çdo datë raportimi dhe kur ekzistojnë indicacione që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar, atëherë drejtimi çmon shumën e rikuperueshme të aktivitetit dhe njeh atë në përputhje me SNK- 36 "Zhvlerësimi i Aktiveve".

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përfundime bëjnë aktivitet afatgjatë materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % të dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

#### 4.6 Aktivet afatgjatë jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri dhe aktiviteti nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiviteti jomaterial bëhet me kosto, ndërsa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

#### 4.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëliti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me

kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

#### 4.8 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojne kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato linden.

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2022 janë 1 euro=114.23 leke dhe 1 dollar=107.05 leke.

#### 4.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime linden nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2022 është 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

### Informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës

#### 5. Mjete Monetare (likuiditete në arke, bankë etj.)

Gjendjet e mjeteve monetare në banke dhe arke, në fillim dhe fund të ushtrimit janë si me poshtë:

| Nr | Përshkrimi i Elementëve   | Monedha    | Viti raportues 31.12.2022 |          | Viti paraardhës 31.12.2021 |          |
|----|---------------------------|------------|---------------------------|----------|----------------------------|----------|
|    |                           |            | Leke                      | Valute   | Leke                       | Valute   |
| 1  | Mjete Monetare ne Arke    | Lek        | 1.554.795                 | -        | 16.487.565                 | -        |
| 2  | Mjete Monetare ne Banke   | Lek/Euro/U | 35.661.353                | -        | 31.207.295                 | -        |
|    | .....                     |            |                           |          |                            |          |
|    | .....                     |            |                           |          |                            |          |
|    | Investime në Tregje shume |            |                           |          |                            |          |
| 3  | Likuide                   | Lek        |                           |          |                            |          |
|    | <b>Totali</b>             |            | <b>37.216.148</b>         | <b>-</b> | <b>47.694.860</b>          | <b>-</b> |

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga B.Shqipërisë.

## 6. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arketueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

| Nr | Përshkrimi i Elementëve                        | Viti Raportues 31.12.2022 |                      | Viti Paraardhës 31.12.2021 |                    |
|----|--|---------------------------|----------------------|----------------------------|--------------------|
|    |  |                           |                      |                            |                    |
| 1  | Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)         |                           | 338.890.859          |                            | 290.702.792        |
| 2  | Njesitë Ekonomike Brenda Grupit                |                           |                      |                            | -                  |
| 3  | Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike       |                           |                      |                            | -                  |
| 4  | Të Tjera (Debitore të tjerë)                   |                           |                      |                            |                    |
|    | Shteti-Tatimi aktual mbi fitimin               |                           | 417.027              |                            | -                  |
|    | Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar               |                           | 17.142.868           |                            | 17.910.155         |
|    | Kerkesa debitore -Dogana                       |                           | 7.867.674            |                            | 2.743.330          |
|    | Kerkesa debitore-Dogana                        |                           | 7.867.631            |                            | 2.743.330          |
|    | Te tjera kerkesa(parapagime+debitore te tjere) |                           | 283.798.111          |                            | 143.222.767        |
|    | Furnitore debitore                             |                           | 843.173.851          |                            | 506.689.077        |
| 5  | Kapital i Nënshkruar i Papaguar                |                           | -                    |                            | -                  |
|    | <b>Shuma</b>                                   |                           | <b>1.499.158.021</b> |                            | <b>964.011.451</b> |

Ne "Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)" jane pasqyruar kerkesat per tu arketuar nga klientet per shitjet e mallrave, të cilat nuk jane arketuar ne fund te ushtrimit.Në këte post jane vendosur dhe kerkesa te tjera te arketueshme dhe tepricat debitore te marrdhenieve me furnitoret.

Ndërsa në "Të Tjera (Debitore të tjerë)" jane pasqyruar kerkesat debitore ndaj tatim taksave, për tatimin mbi vleren e shtuar dhe kerkesa te tjera te pershkruara ne pasqyren e mesiperme.

Drejtimi mendon se të gjitha kerkesat do të arketohen në nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie në vlere.

## 7. Inventari

Vlera kontabël e të gjithë inventareve sipas klasifikimit të bërë nga shoqëria, ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

| Nr | Përshkrimi i Elementëve                    | Viti Raportues 31.12.2022 |                    | Viti Paraardhës 31.12.2021 |                    |
|----|--|---------------------------|--------------------|----------------------------|--------------------|
|    |  |                           |                    |                            |                    |
| 1  | Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme |                           | 232.568.854        |                            | 65.215.969         |
| 2  | Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte      |                           | -                  |                            | -                  |
| 3  | Produkte të Gatshme                        |                           | -                  |                            | -                  |
| 4  | Mallra                                     |                           | 173.055.271        |                            | 247.275.085        |
| 5  | Aktive Biologjike                          |                           | -                  |                            | -                  |
| 6  | AAM të Mbajtura për Shitje                 |                           | -                  |                            | -                  |
| 7  | Parapagime për Inventar                    |                           | -                  |                            | -                  |
|    | <b>Shuma</b>                               |                           | <b>405.624.125</b> |                            | <b>312.491.054</b> |

Politikat kontabel per matjen e inventareve jane bazuar ne SNK-2 "Inventarët". Fillimisht inventaret mjihen me kosto e blerjes qe përfshin çmimin e blerjes, taksat e importit dhe tatime të tjera,(përveç atyre që njësia ekonomike i rikuperon nga autoritetet tatimore) transportin, trajtimin dhe kosto të tjera që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes së mallrave,materialeve dhe shërbimeve. Gjate ushtrimit per daljen e inventareve eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Klasifikimi dhe vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2022.

Shuma e inventarit në "Lëndë e Parë dhe Materiale të Konsumueshme" dhe "Mallra", janë paraqitur me kostot mesatare të blerjes, e cila nga drejtimi, jane vlerësuar si vlera më e ulët midis kosos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.

Pë rrjedhim nuk eshte parashikuar ndonjë shumë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme.Shoqeria nuk ka inventare të dhënë si garanci apo që janë në ruajtje të palëve të tjera.

### 8. Shpenzime të shtyra

Nuk jane evidentuar "Shpenzime të shtyra" në periudhen raportuese.

### 9. Aktivet afatgjata financiare

Nuk ka investimet ne shoqerite e kontrolluara dhe ne pjesmarrje.

### 10. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

| Nr | Gjendjet dhe Lëvizjet          | Toka/Terrene  | Ndertime      | Impiante,makineri, mjete transporti | Të tjera instalime dhe pajisje | Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces | Totali        |
|----|--------------------------------|---------------|---------------|-------------------------------------|--------------------------------|---|---------------|
| A  | Kosto e AAM-ve 01.01.2022      | 1.687.634.531 | 921.953.722   | 600.166.116                         | 133.138.395                    | -   | 3.342.892.764 |
|    | Shtesat                        | 11.661.000    | -             | 45.000.650                          | 603.296                        | -   | 57.264.946    |
|    | Pakësimet                      | (10.829.000)  | -             | -                                   | -                              | -   | (10.829.000)  |
|    | Kosto e AAM-ve 31.12.2022      | 1.688.466.531 | 921.953.722   | 645.166.766                         | 133.741.691                    | -   | 3.389.328.710 |
| B  | Amortizimi AAM-ve 01.01.2022   | -             | (310.381.995) | (438.572.476)                       | (77.382.770)                   | -   | (826.337.241) |
|    | Amortizimi ushtrimit           | -             | (30.578.136)  | (43.294.001)                        | (6.038.299)                    | -   | (79.910.436)  |
|    | Amortizimi për daljet e AAM-ve | -             | -             | -                                   | -                              | -   | -             |
|    | Amortizimi AAM-ve 31.12.2022   | -             | (340.960.131) | (481.866.477)                       | (83.421.069)                   | -   | (906.247.677) |
| C  | Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2022  | -             | -             | -                                   | -                              | -   | -             |
|    | Shtesat                        | -             | -             | -                                   | -                              | -   | -             |
|    | Pakesimet                      | -             | -             | -                                   | -                              | -   | -             |
|    | Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2022  | -             | -             | -                                   | -                              | -   | -             |
| D  | Vlera neto e AAM-ve 01.01.2022 | 1.687.634.531 | 611.571.727   | 161.593.640                         | 55.755.625                     | -   | 2.516.555.523 |
| E  | Vlera neto e AAM-ve 31.12.2022 | 1.688.466.531 | 580.993.591   | 163.300.289                         | 50.320.622                     | -   | 2.483.081.033 |

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kosos(SNK-16). Ne koston e njohjes fillestare te një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) jane përfshire çmimi blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme, pasi zbriten skontot tregtare dhe zbritjet tregtare ose kostoja e ndertimit te tij, si dhe çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjellë aktivin në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Per amortizimin e AAM-ve shoqeria ka zgjedhur metoden vleres se mbetur(amortizim mbi bazen e vleres neto) e cila aplikohet ne menyre te qendrueshme dhe eshte e njejte me ato qe perdoren per qellime fiskale.



Normat e amortizimit të përdorura marrin parasysh jetën e dobishme dhe shumat vjetore të llogaritura sipas grupeve është shpjeguar në tabelën e mesipërme.

Ne datën e raportimit AAM-të paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvleresimi.

Vlera kontabël (neto) e AAM-ve është rishikuar nga drejtimi dhe është konstatuar se nuk gjenden indicacione të besueshme që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar dhe ka çmuar se vlerat neto të paraqitura nuk tejkalojnë shumën e rikuperueshme të tyre.

Klasifikimi i AAM-ve dhe vlerat e paraqitura me sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2022.

Nga aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) nuk ka objekte të përdorura si garanci për pasive.

## 11. Detyrime Afatshkurtera

Detyrimet afatshkurtera në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel paraqiten:

| Nr | Përshkrimi i Elementëve                                  | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|----|--|------------------------------|-------------------------------|
| 1  | Titujt e Huamarrjes                                      | -                            | -                             |
| 2  | Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë                  | 797.347.650                  | 637.579.279                   |
| 3  | Arkëtime në Avancë për Porosi                            | 2.417.500                    | 1.500.000                     |
| 4  | Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)   | 394.628.854                  | 31.930.054                    |
| 5  | Dëftesa të Pagueshme                                     | -                            | -                             |
| 6  | Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup                        | -                            | -                             |
| 7  | Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje                 | -                            | -                             |
| 8  | Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet. |                              |                               |
|    | Paga dhe Shpërblime                                      | 5.725.444                    | -                             |
|    | Sigurime Shoqërore dhe Shënd.+ TAP                       | 2.735.106                    | 2.108.801                     |
| 9  | Të Pagueshme për Detyrime Tatimore                       |                              |                               |
|    | Shteti-Tatim Aktual mbi Fitimin                          | -                            | 11.844.822                    |
|    | Shteti-Tatim mbi Vlerën e Shtuar                         | -                            | -                             |
|    | Parapagimi I TF në vitin 2022, paguar 2022               | -                            | 1.110.781                     |
|    | Tatimi në Burim  | -                            | -                             |
| 10 | Të Tjera të Pagueshme ( kliente kreditor)                | -                            | 8.090.275                     |
|    | <b>Shuma</b>   | <b>1.202.854.554</b>         | <b>694.164.012</b>            |

Në "Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë" janë vendosur huatë e klasifikuara si afatshkurtera, të cilat sipas kredidhenesve ndahen:

| Kredidhënsit                             | Ne monedhën e llogarise | Leke               |
|--|-------------------------|--------------------|
| 5121001-PROCREDIT BANK LEK 200245450001  | All                     | -                  |
| 51240001-PROCREDIT BANK USD 200245450103 | USD                     | 1.199.750          |
| 51240021-OTP BANK EUR 1401606            | EORO                    | 1.815.580          |
| 51240032-Procredid bank usd 005002689    | USD                     | 1.500.000          |
| 51240034-AMERICAN BANK OF INVESTMENTS SA | USD                     | 1.498.605          |
| 51240035-OTP BANK OVD 2 EUR 02182979     | EURO                    | 705.110            |
| Diferenca kredish                        | All                     | -                  |
|  |                         | 20.343             |
| <b>Shuma</b>                             |                         | <b>797.347.650</b> |

"Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve të mbetura të pa u likjuar në fund të ushtrimit. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitoreve dhe llogarive të tjera të pagueshme janë paraqitur me vlerën e tyre reale.

"Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet." paraqet detyrimet e mbetura të pa u paguar ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të muajit Dhjetor 2022.

“Të Pagueshme për Detyrime Tatimore “ janë pasqyruar detyrimet e llogaritura dhe të papaguara për tatimin aktual mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat personale, respektivisht në shumën e treguar në pikën 9 të tabelës. Në “Të Tjera të Pagueshme” është pasqyruar detyrime ndaj shoqerive dhe individëve për marrdhenjet e ndodhura gjatë ushtrimit.

## 12. Detyrimet Afatgjata

Detyrimet afatgjata në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël paraqiten si vijon:

| Nr           | Përshkrimi i Elementëve                            | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|--------------|--|------------------------------|-------------------------------|
| 1            | Titujt e Huamarrjes                                | -                            | -                             |
| 2            | Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë            | 295.749.249                  | 415.197.386                   |
| 3            | Arkëtime në Avancë për Porosi                      | -                            | -                             |
| 4            | Të Pagueshme për Aktivitet Shfrytëzuese(Furnitore) | -                            | -                             |
| 5            | Dëftesa të Pagueshme                               | -                            | -                             |
| 6            | Të Pagueshme Ndaj Njës.Ekon. Grup                  | -                            | -                             |
| 7            | Të Pagueshme Ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje           | -                            | -                             |
| 8            | Të Tjera të Pagueshme                              | -                            | -                             |
| <b>Shuma</b> |  | <b>295.749.249</b>           | <b>415.197.386</b>            |

Në “Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë” janë vendosur huatë e klasifikuara si afatgjate, të cilat sipas kredidhenesve ndahen:

| Kredidhënsit                | Ne monedhen e llogaritjes | Leke               |
|-----------------------------|---------------------------|--------------------|
| 468201-LASING -SOC.GEN.BANK | EURO                      | 9.258              |
| 46823-Bankat ABI            | EURO                      | 716.447            |
| 46824-Bankat OTP            | EURO                      | 149.106            |
| 4681-Bankat-Procredit Bank  | All                       | 195.819.557        |
| <b>Shuma</b>                |                           | <b>295.749.249</b> |

## 13. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur në bilanc, është i njëjti me atë të përcaktuar në statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara në QKR. Me 31.12.2022 ai është 1.800.000.000 lekë.

Me vendim të Ortakut të fitimi i vitit ushtrimor 2021, me vendim të ortakut të vetëm, është kaluar në fitime të pashpërdara.

Gjatë ushtrimit kontabël nuk ka rritje ose pakesim në kapitalin e regjistruar të shoqerisë dhe ndryshime në raportet zoterimit nga ortakët.

## 14. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) të biznesit paraqitet si vijon:



| Nr | Emertimi   | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|----|--|------------------------------|-------------------------------|
| 1  | Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit:                |                              |                               |
|    | Shitje e Produkteve te Gatshme dhe Nënprodukteve         | -                            | -                             |
|    | Shitja e Punimeve dhe Shërbimeve                         | 1.244.690                    | 920.683                       |
|    | Shitja e Mallrave  | 4.773.634.961                | 3.414.086.188                 |
|    | Të Ardhura nga Shitje të tjera(qera,komisione,etj)       | 3.501.914                    | 2.269.216                     |
|    | <b>Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit</b> | <b>4.778.381.565</b>         | <b>3.417.276.087</b>          |
| 2  | Puna e Kryer nga Njesia dhe e Kapitalizuar               | -                            | -                             |
| 3  | Të Ardhura të tjera të Shfrytëzimit                      |                              |                               |
|    | Të Ardhura nga Shitja e Aktiveve Afatgjata               | 11.966.000                   | -                             |
|    | Të Ardhura të tjera (grantet,qera,te tjera,.....)        | -                            | 5.263.249                     |
|    | <b>Shuma</b>   | <b>4.790.347.565</b>         | <b>3.422.539.336</b>          |

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

Midis deklarimeve të kryera dhe të ardhurave të pasqyruara në pasqyrën e performancës rezultojnë një diferencë prej 917.500 leke e cila përfaqëson ndryshimin e gjendjeve të parapagimeve të marra, të vendosura në postin arketime me porosi.

#### 15. Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme

Lëndë të para, materiale dhe mallra etj, të konsumuara gjatë ushtrimit, ndare sipas natyrës së tyre paraqitet si vijon:

| Nr | Emertimi                                   | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|----|--|------------------------------|-------------------------------|
| 1  | Ndryshimi në Inventarin e PG&PP            | -                            | -                             |
| 2  | Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme |                              |                               |
|    | Lënda e Parë dhe Materiale                 | 67.338.034                   | 77.878.856                    |
|    | Mallra                                     | 4.040.206.100                | 2.801.220.448                 |
|    | Uje, energji elektrike                     | 36.596.033                   | 28.186.096                    |
| 3  | Të Tjera Shpenzime                         |                              |                               |
|    | <b>Shuma</b>                               | <b>4.144.140.167</b>         | <b>2.907.285.400</b>          |

Në këtë post të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, është përfshirë kostoja e marrjes së materialeve të para dhe ndihmëse të konsumuara, kostoja e produkteve të gatshme të shitura, si dhe kostoja e energjisë elektrike, ujit etj.

Në këtë rubrikë janë vendosur dhe ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces, ku pakësimet e pozicioneve njihen si shpenzime dhe rritjet e pozicioneve si pakësim i shpenzimeve (shpenzime negative).

#### 16. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet.

Numeri mesatar i punonjësve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si më poshtë :

| Nr  | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|---|------------------------------|-------------------------------|
| 1 Shpenzime Personeli                             |                              |                               |
| Paga dhe Shpërblime                               | 86.117.294                   | 81.238.121                    |
| Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore | 14.378.368                   | 13.533.174                    |
| Të tjera  | -                            |                               |
| <b>Shuma</b>                                      | <b>100.495.662</b>           | <b>94.771.295</b>             |
| 2 <b>Numri mesatar vjetor i të punësuarve</b>     | <b>136</b>                   | <b>147</b>                    |

Ne baze te marrëdhënieve kontraktuale të punës, shoqëria llogarit dhe pasqyron vetem përfitimet afatshkurtra te punonjësve. Njohja dhe matja gjatë periudhës kontabël, behet me vlerën e paskontuar të përfitimeve afatshkurtra të punonjësve që priten të paguhen në këmbim të shërbimit, si detyrim dhe shpenzim.

### 17. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

| Nr | Emertimi   | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|----|--|------------------------------|-------------------------------|
| I  | Të Tjera Shpenzime   |                              |                               |
| 1  | Shërbime nga të tretët (llog.61-62)                            |                              |                               |
|    | Trajtime të përgjithshme (nga te trete)                        |                              |                               |
|    | Qera   | 1.695.068                    | 1.394.431                     |
|    | Mirmbajtje dhe riparime  | -                            | 8.287.541                     |
|    | Sigurime   | 2.345.064                    | 2.354.632                     |
|    | Publicitet, reklama  | 11.812.741                   | 24.054.179                    |
|    | Trasferime, udhëtime, dieta                                    | 24.808.452                   | 11.540.655                    |
|    | Shpenzime postare dhe telekomunikimi                           | 5.897.172                    | 1.462.903                     |
|    | Shpenzime për shërbimet bankare                                | 5.197.091                    | 2.869.319                     |
|    | Të tjera   | 38.174.089                   | 29.518.350                    |
| 2  | Tatime dhe taksa (llog.63)                                     |                              |                               |
|    | Taksa dhe tarifa vendore                                       | 1.898.178                    | 3.337.554                     |
|    | Taksa te regjistrimit  | -                            | -                             |
|    | Tatime te tjera  | -                            | 22.618                        |
| 3  | Shpenzime të tjera jo korente (llog.67)                        |                              |                               |
|    | Vlera kontabël e AA te shitura                                 | 10.829.000                   | -                             |
|    | Te tjera   | -                            | -                             |
| 4  | Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi (Gjoha, provizione) Llog.65,68) |                              |                               |
|    | Shpenzime per pritje dhe përfaqësime                           | -                            | -                             |
|    | Gjoha dëmshpërblime  | 2.989.053                    | 2.878.004                     |
|    | Provizione   | -                            | -                             |
|    | Te tjera   | -                            | -                             |
|    | <b>Shuma</b>   | <b>105.645.908</b>           | <b>87.720.186</b>             |

### 18. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

| Nr                                   | Emertimi                       | Viti Raportues<br>31.12.2022 | Viti Paraardhës<br>31.12.2021 |
|--------------------------------------|--------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| <b>Shpenzime financiare(Llog.65)</b> |                                |                              |                               |
| 1                                    | Shpenzime për interesa         | 33.056.062                   | 31.606.990                    |
| 2                                    | Shpenzime financiare te tjera  |                              |                               |
| 3                                    | Humbje/fitim kembimet valutore | 23.869.155                   | 6.484.678                     |
| 4                                    | Të tjera                       | -                            | -                             |
| <b>Shuma</b>                         |                                | <b>56.925.217</b>            | <b>38.091.668</b>             |

Fitimimet nga kembimi rrjedhin nga rezultatet e vërtetuara nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve dhe e te drejtave dhe detyrimeve te shprehura ne monedha te huaja.

### 19. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Ne vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve.

| Nr.  | Elementët e Tatimit mbi Fitimin   | Viti raportues 2022 |                     | Viti raportues 2021 |                     |
|--|---|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
|  |   | Shuma               | Tatim Fitimi<br>15% | Shuma               | Tatim Fitimi<br>15% |
| <b>I Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin</b>                |   |                     |                     |                     |                     |
| 1  | Fitimi/(Humbja) Para Tatimit  | 230.038.109         | 34.505.716          | 165.853.218         | 24.877.983          |
| 2  | Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-)                               |                     |                     |                     |                     |
|  | Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e kontrollit dhe pjesmarrjes)(-)  | -                   | -                   | -                   | -                   |
|  | Të tjera(rimarrje provizionesh,gjobash etj)(-)  | -                   | -                   | -                   | -                   |
| 3  | Shpenzime te panjohura tatimore(+)  |                     |                     |                     |                     |
|  | Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor(+)  |                     | -                   | -                   | -                   |
|  | Gjoha,penalitet,demshperblime(+)  | 2.989.053           | 448.358             | 2.878.004           | 431.701             |
|  | Amortizim mbi normat fiskale(+)   |                     | -                   |                     | -                   |
|  | Provizione per rreziqe e shpenzime(+)   |                     | -                   |                     | -                   |
|  | Të tjera(+)(kosto te panjohura fiskale,Vlera e shitjeve)                                      | -                   | -                   | 2.772.819           | 415.923             |
| 4  | Diferenca pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus njohjet për qëllimet e raportimit(-) |                     |                     |                     |                     |
|  | Amortizimi i përshpejtuar tatimor(-)  | -                   | -                   | -                   | -                   |
|  | Të tjera(-)   | -                   | -                   | -                   | -                   |
| 5  | Zbritja e humbjes tatimore(-)   | -                   | -                   | -                   | -                   |
| 6  | Fitimi i Tatueshëm dhe shpenzime të tatim fitimit aktual                                      | 233.027.162         | 34.954.075          | 171.504.041         | 25.725.606          |
| <b>II Shpenzim(të ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë(+/-)</b>  |   |                     |                     |                     |                     |
|  |   | x                   |                     | x                   | -                   |
| <b>III Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin(I+II)</b> |   |                     |                     |                     |                     |
|  |   | <b>x</b>            | <b>34.954.075</b>   | <b>x</b>            | <b>25.725.606</b>   |

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kërkesat e legjislacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15%.

Nuk janë identifikuar aktive ,detyrimeve dhe zërave të zjerë që priten të ndikojnë në fitimin e tatueshëm nëse ato do të realizoheshin ose shlyheshin me vlerat e tyre kontabël aktuale, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme. Per rrjedhim nuk është njohur asnjë tatim fitimi i shtyrë.

### Shënime të tjera shpjeguese

## 20. Informacione shpjeguese për palët e lidhura

Duke marre ne konsiderate te gjitha marredheniet e mundeshme me palet e lidhura, transaksionet e kryera me to, janë bërë sipas termave të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura.

## 21. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vijimësia

Asnje ngjarje e rëndësishme nuk është evidentuar ndërmjet datës së bilancit dhe datës kur janë miratuar nga drejtimi keto pasqyrat financiare, si për ngjarjet që mund të ekzistojnë në datën e bilancit dhe për ato që japin të dhëna pas datës së bilancit.

Pasqyrat financiare janë hartuar sipas parimit të vijimesisë dhe nga informacionet e besueshme që zoteron drejtimi nuk ka rreziqe të rëndësishme për të shkaktuar ç'rregullime materiale në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar.

## 22. Te tjera informacione shpjeguese

### **Pasivet e kushtëzuara dhe anagazhimet kontraktuale të panjohura**

Drejtimi ka vlerësuar se nuk ekzistojnë ngjarje të shkuara apo angazhime kontraktuale të panjohura që mund të çojnë në të ardhmen, në një detyrim të mundshëm ose të një pasivi të kushtëzuar dhe që nuk janë në kontrollin e shoqërisë.

### **Manaxhimi i Rrezikut Financiar**

Në aktivitetin normal të biznesit shoqëria kryen transaksione të shumta me instrumenta financiare dhe për rrjedhim është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme financiare që përfshijnë kryesisht riskun e kredise, riskun e likuiditetit dhe riskun e kursit të këmbimit. Bazuar në informacionin e siguruar nga personeli drejtues rreziqet e mundeshme dhe metodat e menaxhimit të tyre jepen në vijim.

**Rreziku i kredisë:** Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë kryesisht për shkak të faturimeve me likuidim të mevonshëm ndaj klienteve të saj. Pjesa kryesore e kërkesave të arketueshme në fund të ushtrimit i i perkasin bizneseve private të cilat kanë siguri në likuidim.

Bazuar në përvojën e viteve të mëparshme, drejtimi vlerëson se mundësia e humbjes në vlerën e tregut si rezultat i pamundësisë së klientit për të paguar borxhin është në nivele shumë të ulta.

**Rreziku i Kursit të Këmbimit:** Shoqëria nuk ka filiale apo dege në vende të tjera gjeografike, por kryen transaksione brenda vendit dhe mban në llogarite e saj likuiditete në monedhe të huaja.

Për shkak të kësaj, ndryshimet në kursin e këmbimit mund të ndikojnë në nivelin e performancës për shkak të ndryshimit të kurseve të këmbimit. Nga të dhënat që zoteron drejtimi mendohet se kurset e këmbimit nuk do ndryshojnë shumë për vitin në vijim. Rreziku i këmbimit menaxhohet kryesisht duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve në valute me detyrimet në valute.

\*\*\*